

# AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “IDEA84”

## KAPITULLI I EMRI, FORMA E SHOQËRISË, SELIA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA

### Neni 1 Themelimi

Sot, më datë 16. 03. 2022 në Durres, Shqipëri.

1.1 Emri i shoqërisë është IDEA84 këtu më poshtë e quajtur “Shoqëria”.

1.2 Shoqëria është themeluar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.

1.3 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.


1.4 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin.

### Neni 2 Selia

- Selia e shoqërisë ndodhet në adresën :  
Durres, Pjeze , ndertese me nr 73/51 zona kadastrale nr 2978
- Shoqëria mund të themelojë degë, filiale dhe/ ose zyra përfaqësimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe/ose në shtete të tjerë, në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe Statutin.

### Neni 3 Objekti

- Veprimtari ne fushen e fasoneve, prodhimin me material porositesi dhe shitjen e tyre,
- Import –eksport te lendes se pare te materialeve ndihmese per prodhime fason, e makinerive dhe pjeseve te kembimit ne fushen e veprimtarise se fasoneve.
- Veprimtari ne fushen e modelimeve, te prerjeve e te qepjeve si rrobaqepsei per cdo lloj amballazhi dhe shitja e tyre brenda vendit dhe per eskportin e tyre.
- Qepje faqe kepucesh me material porositesi, prodhimi dhe montimi i tyre
- Import-eksport dhe tregetim me shumice e pakice i cdo lloj veshjeje dhe konfeskioneve.
- Import – eksport , tregatim me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem,fason, hekurosje ( lavanderi.
- Hapja ekpsozitave, e reklamime te modeleve, veshjeve te realizuara me qellim publikimin e tyre.
- Hapje e kurseve te modelisteve dhe te rroabaqepsise.
- Trajnimi i fuqise punetore pa eksperience ne aktivitetin fason duke zhvilluar kurse te hereparhersh sipas nevojave te punes.
- Pjesemarrja e drejtperdrejte ose e terthorte ne te gjitha transakcionet (operacionet) tregtare ( industriale qe mund te lidhen drejtperdrejt ose terthorazi me nje nga objektet e mesiperme nepern krijimit te shoqerive te reja, kontributeve, regjistrimit / blerjes se aksioneve ose te drejtave



1



kompanise, bashkimit, pjesemarrjes dhe asocimit.

- Per realizimin e objektit te veprimtarise se saj, Shoqeria mund te kryeje, gjithashtu, ne rruge ndihm dhe jo paresore, te gjitha operacionet tregetare, industriale, financiare, detare, mbi pasuri te luajtsh dhe te paluajtshme, ne Shqiperi dhe jashte saj, ne masen qe vleresohet e dobishme dhe/ose pershtatshme nga organi administrativ, operazione qe lidhen direkt ose indirekt me objektir shoqerise, ose me nje objekt te ngjashem, shtojce te lidhura ose ndihmese te te njejtës natyre qe do favorizojne zhvillimin e saj.

Per te gjithë veprimtarite per te cilat do kerkohet autorizim, shoqeria do te pajiset paraprakisht me ose te kryeje regjistrimet e nevojshme. Per zbatimin e te gjitha veprimtarive te permendura shoqe do te punesoje profesioniste. Shoqeria mund te aplikojë per te gjitha lehtesirat dhe perfitimit parashikuara nga legjislazioni ne fuqi dhe nga ai qe do te miratohet.

Te gjitha veprimtarite e pershkruara me siper mund te zhvillohen si ne Shqiperi ashtu edhe jas vendit.

#### **Neni 4**

##### **Kohëzgjatja**

4.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar

## **KAPITULLI II**

### **KAPITALI FILLESTAR THEMELTAR; KONTRIBUTET, KUOTAT –PJESET E KAPITALI**

#### **Neni 5**

##### **Kapitali Themeltar dhe Ortaket**

5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 Lek. Kapitali i shoqërisë zotërohet nga ortaket mëposhtëm:

- **Z. Etmond Duka** , shtetas Shqiptar , lindur në Tirane më 06.07.1981 identifikuar me leternjoftim I10706204J pronar i një kuote te Shoqerise me vlerë 100.000,00 Lek, që përfaqëson 100% të kapit social me të drejtë vote.


5.2 Kapitali themeltar është nënshkruar dhe shlyhet plotësisht me kontribute në para nga ortaku.

#### **Neni 6**

##### **Transferimi i Pjesëve – Kuotave**

Çdo ortak mund t'ia transferojë pjesët e tij në kapitalin e Shoqërisë çdo pale të tretë me komunikim n ortakeve te tjere nepermjet letre rekomande, oferten e marre, duke treguar emrin e bleresit te mundsh dhe kushtet e tjetersimit, ne menyre te veçante çmimin e percaktuar dhe menyren e pageses (ketu e poshte Oferta). Ortakët e tjerë duhet t'i përgjigjen njoftimit të Ortakut transferues nëse dëshirojnë ushtrojnë të drejtën e parablerejs, me të njëjtat kushte, brenda një periudhe prej 30 ditësh. Në rast të përgjigjeje negative ose nëse Periudha e Njoftimit kalon pa përgjigje, Ortaku transferues mund të proced me transferimin e pjesëve te pala e tretë.

## **KAPITULLI III**





## ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

### Neni 7

#### Asambleja e Përgjithshme

- 7.1 Asambleja e Përgjithshme është organi me i lartë vendimmarrës i Shoqërisë. Vendimet e Asamblesë Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me dispozitat e këtij Statuti, janë detyrueshme për të gjithë Ortakët, pavarësisht janë apo jo të pranishëm në mbledhje, janë apo jo dak me këto vendime.
- 7.2 Asambleja e Përgjithshme ka funksionet e mëposhtme:
- Përcakton politikat tregtare dhe ekonomike të Shoqërisë dhe mbikqyr zbatimin e këtyre të fundit r administratori;
  - Emeron dhe shkarkon administratoret
  - Përcakton shperblimin e administratoreve;
  - Miraton pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë të përgatitura r administratori;
  - Merr vendimin për ndryshimet Statutore
  - Merr vendim për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;
  - Merr vendimin për shpërndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve;
  - Merr vendimin për riorganizimin e Shoqërisë ose prishjen e saj;
  - Merr vendim për cdo ceshtje tjeter te parashikuar nga ligji.

### Neni 8

#### Thirrja e Asamblese

- 8.1 Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme mund te thirret nga Adminisratori(ret) apo secili prej Ortake me njoftim derguar ortakeve ne vendbanimin e tyre ose ne adresen e postes se tyre elektronike dk marre prej ketyre te paktën 7 (shtate) dite perpara dates se caktuar per mbledhjen e asamblese. njoftimin e thirrjes duhet te tregohen vendi, dita dhe ora e mbledhjes dhe lista e ceshtjeve ne rend dite.
- 8.2 Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme zhvillohet normalisht në selinë e Shoqerise ose diku tje brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, ose me telekonferencë.
- 8.3 Asambleja e Pergjithshme shprehet ne menyre te vecante per cdo ceshtje te rendit te dites , per te ci duhet te merret nje vendim I vecante.
- 8.4 Ortaket mund te marrin pjese ne Asamblene e Pergjithshme personalisht ose nepermjet perfaqesuesi autorizuar me procure. Administratori (et) e shoqerise nuk mund te perfaqesojne Ortaket ne Asamble e Pergjithshme

### Neni 9

#### Procesi i vendimmarrjes

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme mblidhet sipas nevojës, por në çdo rast të paktën një herë në vit.
- 9.2 Asambleja e Përgjithshme quhet e mbledhur rregullisht kur jane të pranishëm Ortaket qe zotërojnë shumë se 30% të kapitalit të Shoqerise. Në mungesë të kuorumit të kërkuar, mbledhja shtyhet për ( tridhjetë) ditë, me të njëjtin rend dite.



- 9.3 Asambleja e Përgjithshme merr vendime me shumicë të thjeshtë, në lidhje me çështje për të cilat li nuk kërkon një shumicë të cilësuar përcaktuar në pikën 9.4 si më poshtë.
- 9.4 Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicë të cilësuar prej  $\frac{3}{4}$  e votive te ortakeve te pranishem lidhje me:

- Ndryshimin e Statutit;
- Rritjen dhe zvogëlimin e kapitalit
- Shpërndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve;
- Riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë

## Neni 10

### Administratori

- 10.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administratorë, të cilët do të veprojnë vecmas një tjetrit.
- 10.2 Administrator i shoqërisë është:  
Z. Etmond Duka, shtetase shqiptar datëlindjes lindur në Tirane më 06.07.1981 identifikuar leternjoftim nr. I10706204J
- 10.3 Mandati i Administratorit është për një periudhë prej 5 (pese) vitesh i rinovueshëm, dhe , nëse është rasti, vazhdon deri në vendimin e ardhshëm të Asamblesë së Përgjithshme që do të marrë vendim lidhje me rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e administratorit të ri.
- 10.4 Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratori. Administratori ka të drejtë të leshojë prokur apo autorizime të veçanta.  
Përveçse kur parashikohet ndryshe,
- 10.5 Administratori ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:
- Administrimin e veprimtarisë së Shoqërisë duke zbatuar politikën tregtare dhe ekonomike përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme;
  - Përfaqësimin e Shoqërisë në marrëdhënie me çdo palë të tretë;
  - Marrjen e masave për hartimin dhe mbajtjen në mënyrë të duhur të pasqyrave financiare dhe dokumenteve;
  - Përgatitjen dhe nënshkrimin e pasqyrave financiare vjetore dhe bilanceve të konsoliduara përgatitjen e raportit të ecurisë dhe dorezimin e ketyre të fundit bashkë me propozimin përkatës për shpërndarjen e fitimeve Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
  - Dorezimin në Qendren Kombëtare të Biznesit të dokumentave dhe të të dhënave të shoqërisë përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe;
  - Raportimin në Asamblesë të Përgjithshme të Ortakeve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare të Shoqërisë dhe në lidhje me emërimin e transaksioneve të rëndësishme të veçanta për ecurinë e Shoqërisë;
  - Kryerjen e çdo detyre tjetër të parashikuar nga ligji ose nga ky statut;
- 10.6 Administratori mund të autorizojë nëpërmjet një prokure një palë të tretë të përfaqësojë Shoqërinë në të nënshkruarë çdo dokument, kërkesë ose aplikim në emër dhe për llogari të shoqërisë.
- 10.7 Administratorët do të kryejnë çdo transaksion, të lidhin, rinovojnë, përfundojnë çdo marrëveshje dhe kontratë, të ndermarrin çdo veprim, detyrim, sipërmarrje, të kryejnë ndonjë veprim tjetër.
- 10.8 Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë për çdo dëm të shkaktuar si pasoje e mospërbushjes së detyrimeve të parashikuara nga dispozitat e këtij Statuti dhe legjislacioni në fuqi.



**KAPITULLI IV**  
**VITI FINANCIAR- SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

**Neni 11**

**Viti financiar**

11.1 Viti financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Në përfundim vitit kalendarik Administratori harton pasqyrat financiare të shoqërisë në përputhje me ligjet në fuqi.

**Neni 12**

**Shpërndarja e fitimeve**

12.1 Pas miratimit të pasqyrave financiare dhe në rast se janë realizuar fitime, Asambleja e Përgjithshme vendos në lidhje me shpërndarjen ose jo të fitimeve.

12.2 Në rast se pas miratimit të pasqyrave financiare Shoqëria rezulton me humbje, Asambleja Përgjithshme vendos në lidhje me mbulimin e humbjeve

**KAPITULLI V**  
**PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

**Neni 13**

**Prishja dhe likuidimi**

13.1 Në rast se Asambleja e Përgjithshme vendos për prishjen e shoqërisë, do të emërohen një ose shumë likuidues.

**KAPITULLI VI**  
**DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

**Neni 14**

**Ligji I Zbatueshëm**

14.1 Për të gjitha çështjet që nuk parashikohen në këtë statut do të zbatohen dispozitat përkatëse legjislativitetit shqiptar në lidhje me shoqëritë tregtare

**Neni 15**

**Të ndryshme**

Ky Akt Themelimi dhe Statut është hartuar dhe nënshkruar në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe

**ORTAKU**

**ETMOND DUKA**

